REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
MUNICIPAL GJILAN - OPŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDIYESI

# PLANI KOMUNAL PËR INTEGRITET
# 2024 - 2026

*Raporti*

*Periudha janar – dhjetor 2025*

*Janar 2026*

**Deklarata e Integritetit**

Zbatimi i Planit të Integritetit gjatë vitit 2025 ka qenë dhe mbetet një angazhim i qartë i Komunës së Gjilanit për qeverisje të ndershme, transparente dhe në shërbim të qytetarëve.

Edhe pse viti u shoqërua me sfida të mëdha institucionale dhe financiare – përfshirë moszbatimin praktik të buxhetit 2025 dhe funksionimin me buxhet emergjent – ne kemi ruajtur fokusin në mbrojtjen e interesit publik, menaxhimin e përgjegjshëm të resurseve dhe forcimin e integritetit institucional.

Vonesat në vendimmarrje dhe kufizimet buxhetore ndikuan në realizimin e projekteve zhvillimore dhe në funksionimin normal të komunës, megjithatë këto rrethana vetëm sa e forcuan bindjen tonë se integriteti, llogaridhënia dhe transparenca janë thelbësore për ruajtjen e besimit të qytetarëve dhe për zhvillim të qëndrueshëm.

Miratimi me kohë i buxhetit për vitin 2026 paraqet një mundësi të re për stabilitet financiar, vazhdimësi të projekteve dhe përmirësim të praktikave të qeverisjes.

Në këtë kontekst, Plani i Integritetit nuk është thjesht një dokument formal, por një udhërrëfyes që siguron se çdo vendim, çdo investim dhe çdo veprim institucional udhëhiqet nga parimet e etikës, përgjegjësisë dhe shërbimit ndaj qytetarëve.

Si Kryetar i Komunës së Gjilanit, riafirmoj përkushtimin ndaj politikës së "zero tolerancës" ndaj korrupsionit dhe ndaj ndërtimit të një administrate profesionale, të hapur dhe llogaridhënëse.

Vetëm përmes bashkëpunimit institucional, vendimmarrjes me kohë dhe respektimit të Planit të Integritetit mund të sigurojmë që resurset publike të menaxhohen drejt dhe që Gjilani të ecë përpara me besim, stabilitet dhe zhvillim.

***z. Alban Hyseni,***
***Kryetari i Komunës së Gjilanit***

## Hyrja

Në përputhje me nenin 25 të Ligjit nr. 08/l-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe duke iu referuar "Metodologjisë së Planeve të Integritetit", të gjitha institucionet janë të detyruara të hartojnë dhe miratojnë planet e integritetit.

Komuna e Gjilanit ka realizuar këtë detyrim duke hartuar dhe miratuar Planin e Integritetit për periudhën 2024-2026.

Ky plan, i cili ka një periudhë zbatimi trevjeçare dhe përditësohet çdo vit, shërben si një instrument të rëndësishëm për vlerësimin e nivelit të integritetit brenda institucionit. Ai ofron masa të strukturuara për menaxhimin e integritetit, me qëllim që të arrihen objektivat e përcaktuara për këtë fushë.

Raportet dhe Plani i Integritetit mund të gjenden të publikuara në ueb-faqen e Komunës së Gjilanit duke klikuar në linkun e mëposhtëm :

linku:
***https://gjilan.rks-gov.net/plani-i-integritetit/***

si dhe dhe linku :
***https://gjilan.rks-gov.net/raportet-periodike/***

Plani thekson përkushtimin e komunës së Gjilanit për të forcuar kontrollin e aktiviteteve operative në të gjitha sektorët e veprimit të komunës. Ai përshkruan masat e bazuara në analizën e rrezikut për të arritur objektivat e institucionit, duke u fokusuar në forcimin e sundimit të ligjit dhe promovimin e vlerave dhe standardeve profesionale.

Kjo qasje sistematike dhe e dokumentuar është e nevojshme për të garantuar një nivel më të lartë të integritetit dhe transparencës në administratën lokale, duke kontribuar kështu në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe më të përgjegjshme.

## PERMBAJTJA E PLANI TE INTEGRITET

Përmban elementet e mëposhtëm:

- një vetëvlerësim të ekspozimit të institucionit ndaj korrupsionit dhe formave të tjera të shkeljes së integritetit;
- informacion për fushëveprimin e institucionit dhe burimet njerëzore të angazhuara në institucion;
- llojet e rreziqeve të korrupsionit dhe format e tjera të shkeljes së integritetit;
- masat ekzistuese të kontrollit;
- masat parandaluese për zvogëlimin e rrezikut të korrupsionit dhe format e tjera të shkeljes së integritetit dhe afatet për zbatimin e tyre;
- informacion për personin përgjegjës për menaxhimin e hartimit dhe zbatimit të planit të integritetit;
- të dhëna të tjera, në përputhje me Metodologjinë për hartimin e planit të integritetit.

Përmes Planit të Integritetit synohet:

- Rritjen e mundësive që institucionit të arrijë objektivat e menaxhimin e integritetit;
- Identifikimi i rreziqeve dhe masave për zvogëlimin e rreziqeve;
- Përmirësimin e kontrolleve ndaj rreziqeve të identifikuara;
- Mbajtjen e një sistemi për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat dhe standardet ligjore dhe procedurale;
- Rritjen e besimit të stafit dhe palëve të jashtme të interesit në përkushtimin për integritet që demonstrohet nga Institucioni.

## Qëllimet e Planit të Integritetit

- Sistem efektiv i menaxhimit të integritetit në institucion;
- Llogaridhënie publike dhe transparencë;
- Rezistencë institucionale ndaj cenimeve të integritetit;
- Planifikim i menaxhimit të rrezikut ndaj integritetit në institucion.

## Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit

Zhvillimi i Planit të Integritetit përbëhet prej disa faza si në vijim:

- Faza e parë**:** Drejtuesi/personi përgjegjës te institucionit merr vendim për emërimin e një Koordinatorit dhe Grupit Punues për hartimin e Planit të Integritetit. Ky grup pune përbëhet nga anëtarë kredibilvarësi të kompleksitetit të institucioni ose numrit të punonjësve. Grupi punues shqyrton kornizën ligjore (rregulloret, planet, kontrollin e brendshëm të auditimit, sistematizimin dhe përshkrimin e vendeve të punës, si dhe burime të tjera informacioni për fushat dhe proceset e punës).

- Faza e dytë**:** Grupi punues ka mbajtur takime të rregullta me qëllim të përpunimit të të dhënave respektivisht përcaktimit të fushave të rrezikut dhe identifikimit të rreziqeve. Ndër të tjerash, takimet janë mbajtur më datë: 16.02.2023, 13.12.2023 dhe 12.01.2024. Përpos takimeve, jemi konsultuar në vazhdimësi përmes emailit dhe kemi kërkuar që anëtarët e grupit të dërgojnë komentet dhe propozimet e tyre në raport me Planin.

- Faza e tretë**:** Grupi punues ka përdorur të dhënat e siguruara për t’i përpiluar tabelat e rrezikut dhe të adresoj cenueshmërinë e integritetit dhe propozon masat për përmirësim. Në fund, komuna publikon planin e integritetit dhe miraton masat për përmirësimin e integritetit për periudhën tre (3) vjeçare.

## Monitorimit i zbatimit të Planit të Integritetit dhe raportimi

Zbatimi i Planit të Integritetit do të monitorohet në vazhdimësi nga Zyrtari përgjegjës brenda institucionit dhe nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit.

Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit është i rëndësishëm për t'u siguruar se kontrolli i rrezikut të integritetit dhe masat për trajtim janë efektive, si në hartim ashtu edhe në zbatim, dhe se procedurat janë kuptuar, si dhe plani integriteti është ndjekur.

Gjithashtu, monitorimi duhet të përcaktojë nëse masat e përdorura për trajtimin e rreziku kanë prodhuar efektet e planifikuara, kanë zbuluar ndryshimet në kontekstin e jashtëm dhe të brendshëm përfshirë ndryshimet e vetë rrezikut, ndryshime që kërkojnë rishikimin e trajtimit dhe prioriteteve të rrezikut si dhe kanë identifikuar cilat mësime duhen nxjerrë për planifikim në të ardhmen.

Raportimi i rregullt siguron se zbatimi i Planit bëhet në përputhje me orarin dhe se rezultatet e planifikuara janë arritur. Gjithashtu, pas hartimit të raportit për zbatimin e planit të integritetit nga zyrtari përgjegjës brenda një institucion, raporti duhet të dërgohet për vlerësim në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.

## Fushat e rrezikut

### Fushat e përgjithshme të Rrezikut

***Fushat e përgjithshme të rrezikut shembull janë***:

- Drejtimi dhe menaxhimi;
- Politika e burimeve njerëzore, sjellja etike dhe profesionale e të punësuarve;
- Planifikimi dhe menaxhimi i buxhetit dhe financave; dhe
- Ruajtja dhe siguria e të dhënave dhe dokumentacionit.

### Fushat specifike të rrezikut

Fushat specifike mund të ndryshojnë varësisht nga specifikat e Institucionit.

***Fushat e specifike të rrezikut shembull janë:***

- Auditimi i brendshëm;
- Prokurimi publik;
- Menaxhimi i kontratave publike;
- Zhvillimi ekonomik lokal dhe bujqësia;
- Planifikimi urban dhe rural;
- Standardet e ndërtimit dhe kontrolli;
- Inspektimet;
- Arsimi publik;
- Shëndeti publik.

# Tabela për Zbatimin e Planit të Integritetit-Komuna e Gjilanit – periudha janar - dhjetor 2025

| Të dhënat e Planit të Integritetit | | | | | | Raportimi i zbatimit | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr** | **Fusha e rrezikut** | **Përshkrimi i Rrezikut** | **Masa e propozuar** | **Njësia/zyrtari përgjegjës** | **Afati i realizimit** | **Veprimet e ndërmarra** | **Niveli i realizmit** | **Mjetet e verifikimit** | **Vështirësitë** | **Rekomandimet** |
| 1. | DREJTIMI DHE MENAXHIMI | Komuna e Gjilanit është përballur me rreziqe institucionale me përgjithat komunikimi me qytetarët është ruajtur. | Rritja e koordinimit institucional dhe transparencës për të zbutur ndikimin e vonesave buxhetore. | Kryetari i Komunës,<br><br>Drejtorit Komunale | TM1 TM2 dhe TM3 TM4 2025 | Në përputhje me ligjin dhe Statutin e Komunës, janë organizuar dy debate publike me qytetarët për prezantimin e raportit gjashtëmujor dhe raportit vjetor të punës së Kryetarit të Komunës gjatë vitit 2025 \| takimi i pare është mbajtur me date 16 korrik ndërsa takimi i dyte me 30 dhjetor<br><br>Për me shume informata / kliko linkun ne web faqe te Komunës se Gjilanit :<br><br>https://gjilan.rks-gov.net/lajmet/<br><br>Kryetari i Komunës se Gjilanit, Alban Hyseni, ka pritur në takim drejtorin e OSBE-së në rajonin e Gjilanit, e Igli Totozanin, me bashkëpunëtorë.<br>Në këtë takim u diskutua lidhur mes situatën aktuale në Komunën e Gjilanit pas zgjedhjeve lokale, rizgjedhjes së kryetarit Alban Hysenit, si dhe për bashkëpunimin e deritanishëm dhe për të ardhmen.<br><br>Për me shume informata / kliko linkun ne web faqe te Komunës se Gjilanit :<br><br>https://gjilan.rks-gov.net/news/kryetari-hyseni-priti-drejtorin-e-osbe-se-ne-rajonin-e-gjilanit/<br><br>Është caktuar seanca inauguruese e Kuvendit të Komunës së Gjilanit, e cila do të mbahet më 10 dhjetor 2025, me fillim në orën 10:00.<br>Në këtë seancë, anëtarët e zgjedhur të Kuvendit dhe kryetari i Komunës, Alban Hyseni, do ta japin betimin.<br><br>Për me shume informata / kliko linkun ne web faqe te Komunës se Gjilanit : | **E realizuar!** | https://gjilan.rks-gov.net/news/kryetari-alban-hyseni-prezanton-raportin-gjashte-mujor-te-punes/<br><br>https://gjilan.rks-gov.net/news/kryetari-hyseni-prezantoi-para-qytetareve-raportin-vjetor-te-punes-per-vitin-2025/ | Mosfunksionimi i Kuvendit Komunal dhe vonesat buxhetore kanë kufizuar zbatimin e plotë dhe në kohë të aktiviteteve të planifikuara gjatë vitit 2025. | Forcimi i koordinimit institucional dhe transparencës ndaj qytetarëve. |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | https://gjilan.rks-gov.net/news/seanca-inauguruese-e-kuvendit-te-komunes-se-gjilanit-do-te-mbahet-me-10-dhjetor-2025/<br><br>Gjate muajit tetor : NJDNJ – Zyra për Barazi Gjinore në bashkëpunim me Strehimoren për Mbrojtjen e Gruas dhe Fëmijës "Liria", kanë shënuar sot hapjen e fushatës globale "16 Ditët e Aktivizmit kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje"..<br><br>Për me shume informata / kliko linkun ne web faqe te Komunës se Gjilanit :<br><br>https://gjilan.rks-gov.net/news/komuna-e-gjilanit-shenon-hapjen-e-fushates-16-ditet-e-aktivizmit-kunder-dhunes-me-baze-gjinore/<br><br>Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në seancën e dytë të mbajtur të martën me date 6 janar 2026 ka zgjedhur Krenare Latifi-Kqikun (VV) për kryesuese, në këtë përbërje për katër vitet e ardhshme.<br>Latifi-Kqiku është zgjedhur në raudin e dytë të votimit, me 18 vota për, të cilat kanë qenë të mjaftueshme, duke qenë se Kuvendi i Komunës përbëhet prej 35 anëtarëve.<br><br>Për me shume informata / kliko linkun ne web faqe te Komunës se Gjilanit :<br><br>https://gjilan.rks-gov.net/news/krenare-latifi-kqiku-zgjidhet-kryesuese-e-kuvendit-te-komunes-se-gjilanit/ | | | | |
| 1.1 | | Mosmiratimi i buxhetit për vitin 2025 ka rrezikuar funksionimin e institucionit. | Bashkëpunim intensiv me grupet politike për miratimin e buxhetit. | Kryetari i Komunës,<br><br>Drejtorit Komunale | TM1 TM2 dhe TM3 TM4 2025 | Janë organizuar seanca urgjente dhe konferenca për arritjen e marrëveshjes.<br><br>Komuna e Gjilanit gjatë vitit 2025 operoi me buxhet emergjent, duke shpenzuar vetëm 1/12 e buxhetit të vitit 2024 në baza mujore. Kjo kufizoi ndjeshëm investimet, solli vonesa në projektet kapitale dhe vështirësoi zhvillimin ekonomik, veçanërisht për bizneset dhe punëtorët e përfshirë në projekte publike. | **E realizuar!** | https://2lonline.com/kryetari-i-komunes-i-bene-thirrje-opozites-per-te-reflektuar/ | Mospajtime ndërmjet grupeve vendimmarrëse | Intensifikimi i dialogut dhe ndërtimi i një klime bashkëpunuese |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.2 | | Objektivat dhe prioritetet zhvillimore të komunës janë të paqarta dhe jo transparente. | Rishikimi dhe miratimi i Planit Zhvillimor Komunal për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm. | Kryetari i Komunës,<br><br>Drejtorit Komunale | TM1 TM2 dhe TM3 TM4 2025 | Objektivat dhe prioritetet janë komunikuar me grupet parlamentare, qytetarët dhe komunitetin e biznesit.<br><br>Është hartuar drafti i Planit Zhvillimor dhe janë krijuar ekipet mbështetëse për sistemin e të dhënave / planifikohet qe ne vitin 2026 te aprovohet Planit Zhvillimor komunal për Komunën e Gjilanit | **Në proces!** | 0002. Vendimi per PZHK - Komuna e Gji<br><br>0001. Vendimi per PZHK - Komuna e Gji | Harmonizimi me komunat fqinje dhe mosmiratimi nga kuvendi | Integrimi i nevojave të qytetarëve dhe komunitetit në Planin Zhvillimor Komunal |
| 1.3 | | Opinion publik negativ dhe humbja e besimit në punën e administratës dhe Kuvendit Komunal | Përditësimi i informacionit dhe funksionalizimi i webfaqes zyrtare për transparencë dhe informim të qytetarëve | Kryetari i Komunës,<br><br>Drejtorit Komunale | TM1 TM2 dhe TM3 TM4 2025 | Në gjysmën e parë të vitit janë identifikuar sfidat e dokumenteve dhe kategorive, ndërsa në gjysmën e dytë, këto probleme janë eliminuar dhe versioni i ri i webfaqes funksionon shumë mirë, duke siguruar qasje dhe transparencë të plotë për qytetarët.<br><br>Të dhënat janë përditësuar dhe janë të qasshme, duke rritur transparencën dhe besimin. | **E realizuar!** | Sfidat fillestare në mungesën e dokumenteve dhe kategorive të rëndësishme ne web faqe.<br><br>**Tani** Komunikimi është përmirësuar dhe qytetarët kanë qasje më të lehtë te informacioni i komunës | Të vazhdohet përditësimi i rregullt i përmbajtjes për të ruajtur transparencën dhe informimin e qytetarëve | |
| 1.4 | | Përfshirja e shoqërisë civile në hartimin e politikave publike komunale ishte e paqartë dhe jo sistematike | Forcimi dhe institucionalizimi i përfshirjes së shoqërisë civile në proceset e hartimit të politikave publike | Kryetari i Komunës<br><br>OJQ-të<br><br>Drejtorit Komunale | TM1 TM2 dhe TM3 TM4 2025 | Bashkëpunimi me OJQ-të nuk ka munguar gjatë gjithë vitit. Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe ajo e Bujqësisë kanë organizuar panairet lokale: më 17 shkurt (Dita e Pavarësisë), 7-8 mars (Dita e Gruas), 15 qershor (Dita e Çlirimit të Gjilanit), Ditët e Diasporës në bashkëpunim me Oden Ekonomike të Kosovës, dhe panairin e 28 nëntorit për Ditën e Flamurit.<br><br>Panairet janë realizuar gjithashtu me pjesëmarrjen e OJQ-së "Gruaja Hyjnore" dhe mbështetje nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) dhe Platforma CiviKos – Prishtinë. | **E realizuar!** | https://gjilan.rks-gov.net/news/permbyllet-panairi-tradicional-forco-traditen/<br><br>https://gjilan.rks-gov.net/news/hapet-panairi-rajonal-anamorava-mirepret-diasporen/ | Të rritet mbështetja financiare dhe koordinimi për organizimin efikas të panaireve të ardhshme | |
| 1.5 | | Përgjegjësi të paqarta për monitorimin dhe raportimin e Planit të Integritetit | Përcaktimi i përgjegjësive për monitorimin dhe raportimin e Planit të Integritetit | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunale | TM1 TM2 dhe TM3 TM4 2025 | Si koordinator i Planit të Integritetit, kam siguruar publikimin e planit dhe të gjitha raportet periodike dhe vjetore në webfaqen e Komunës duke garantuar transparencë dhe qasje të lehtë për qytetarët dhe institucionet. | **Në vazhdimësi!** | https://gjilan.rks-gov.net/plani-i-integritetit/<br><br>https://gjilan.rks-gov.net/raportet-periodike/ | Nevoja për përkushtim të vazhdueshëm për ndjekjen e masave | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.6 | | Takime informuese me stafin për Planin e Integritetit | Koordinatori i planit të integritetit | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunale | TM1 TM2 dhe TM3 TM4 2025 | Për vitin 2025, takimet informuese u vonuan për shkak të zgjedhjeve lokale dhe mungesës së disa drejtorëve.<br><br>Me fillimin e funksionimit të qeverisë së re, gjatë vitit 2026 do të organizohen takime grupore dhe individuale me drejtori dhe sektorë për njohjen e Plotë me Planin e Integritetit. | **Në proces!** | Raportet e brendshme të komunikimit | Nuk janë hasur vështirësi gjatë takimeve | |
| **2.** | POLITIKA E BURIMEVE NJERËZORE, SJELLJA ETIKE DHE PROFESIONALE E TË PUNËSUARVE | Politika e burimeve njerëzore, sjellja etike dhe profesionale e të punësuarve | Mos plotësimi i vendeve të punës me staf adekuatë dhe të mjaftueshëm | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunale | TM1 TM2 dhe TM3 TM4 2025 | Në vitin 2025, 14 pozita të lira janë plotësuar, ndërsa Kuvendi ka miratuar Rregulloren për organizimin e brendshëm të vendeve të punës.<br><br>Aktualisht komuna ka 294 të punësuar (185 meshkuj, 109 femra; 268 shqiptarë, 18 serbë, 6 turq, 1 rom, 1 boshnjak). | **E realizuar!** | Te gjitha konkurset publikohen ne web faqe :<br><br>https://gjilan.rks-gov.net/konkurset-njoftimet/ | Daljet në pension dhe pozitat e lira kërkojnë vazhdimësi në konkurse | |
| 2.1 | | Vlerësimi periodik i rezultateve të punës së zyrtarëve | Të përgatiten dhe analizohen raporte të punës për secilin zyrtar | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunale | TM1 TM2 dhe TM3 TM4 2025 | Zyrtarët përgatisin raporte javore, mujore dhe vjetore; drejtoret vlerësojnë dhe japin feedback në koordinim me Zyrën e Personelit | **E realizuar!** | Raportet pasqyrojnë punën individuale te secilit zyrtar komunal | Nuk ka vështirësi të veçanta | Të vazhdohet monitorimi dhe vlerësimi i punës në mënyrë të rregullt |
| 2.2 | | Trajnimi i vazhdueshëm i të punësuarave në përputhje me planin dhe nevojat për trajnime | Njësia e Burimeve Njerëzore,<br><br>Drejtoret e Drejtorive | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunale | TM1 TM2 dhe TM3 TM4 2025 | Zyrtar nga komuna e Gjilanit : kemi mare pjese n'punëtori me Zyrtarët Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave dhe grupin punues për hartimin e Ligjit për Mbeturina ndërlidhur me prezantimin e draftit të ri të Ligjit për Mbeturina si dhe shkëmbimin e përvojave nga vizita studimore në Slloveni (zyrtar komunal nga Komuna e Gjilanit ishin pjese e kësaj vizite) dhe procesin e Planit Ndër komunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave dhe Marrëveshjes për Bashkëpunim Ndër komunal, si dhe prezantimi i studimit të zhvilluar mbi sfidat dhe mundësitë e bashkëpunimit të komunave me KRM-të.<br><br>shiko pjesëmarrjet tjera : dokumentet ne attachment / te kolona : Mjetet e verifikimit | Punëtoria synon prezantimin e analizës, diskutimin e Ligjit për Mbeturina, shkëmbimin e praktikave nga Sllovenia dhe hapat drejt finalizimit të bashkëpunimit ndërkomunal. | PDF Seminar - Agjenda GIZ - Ekonomi Qarko<br><br>PDF GAP - GIZ - Ftesa dhe Agjenda - Trajn<br><br>PDF fteseä - puntoria KLGI.pdf | Pjesëmarrja e kufizuar për shkak të numrit të kufizuar të vendeve në trajnim. | Bashkëpunimit të vazhdueshëm me GIZ AAK, GAP, ATRC, (KLGI) - Institutit Kosovar për Qeverisje Lokale etj |
| 2.3 | | Shpërndarja e Kodit të Etikës për të gjithë | Kryetari i komunës dhe i Kuvendit, | Kryetari i Komunës | TM1 TM2 dhe | Njësia e personelit, përmes e-mailit zyrtar, ka shpërndarë Kodin e Etikës për të gjithë zyrtarët komunalë, duke theksuar rëndësinë e tij në | **E realizuar!**<br><br>Kodi i Etikës është | PDF Kodi i Etikes - Komuna e Gjilanit.p | Mungesa e trajnimeve dhe e aktiviteteve | Nevoja për trajnime! |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | zyrtaret komunal. | Njësia e Burimeve Njerëzore, | Drejtorit Komunale | TM3 TM4 2025 | sigurimin e transparencës, ndershmërisë dhe përgjegjshmërisë në administratën publike.<br><br>Ky hap përbën një gur themeli në ndërtimin e një kulture të integritetit, në parandalimin e korrupsionit dhe në ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët. | shpërndarë, por zbatimi praktik mbetet i pjesshëm për shkak të mungesës së trajnimeve dhe takimeve për vetëdijesim. | | informuese pengon zbatimin efektiv. | |
| 2.4 | | Mosprani min dhe trajtimin në mënyrë adekuate të informatav e sinjalizime ve nga sinjalizuesi t/informato rët | Caktimi i zyrtarit përgjegjës për sinjalizim | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunale | TM1 TM2 dhe TM3 TM4 2025 | Komuna e Gjilanit, në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, ka ndërmarrë masa konkrete për zbatimin e këtij ligji, duke u bazuar në nenin 17 dhe standardet më të mira të transparencës dhe llogaridhënies.<br><br>Me qëllim të forcimit të integritetit institucional dhe mbrojtjes së sinjalizuesve, gjatë vitit 2026 në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Gjilanit, në seksionin **Shërbimet** ([https://gjilan.rks-gov.net/sherbimet/](https://gjilan.rks-gov.net/sherbimet/) ), do të funksionalizohet edhe linku i veçantë **"Sinjalizuesi"**, i cili do të ofrojë informim të qartë dhe qasje të lehtë për qytetarët dhe zyrtarët komunalë | **E realizuar!**<br><br>sipas Ligjit Nr. 06/L-085, me vendim komunal si dëshmi. | Vendim Sinjalizuesi.pdf<br><br>[https://sinjalizuesi.com/rreth-nesh/](https://sinjalizuesi.com/rreth-nesh/) | Sfida në zbatimin praktik për shkak të mungesës së përvojës paraprake | |
| 3. | PLANIFIKIMI DHE MENAXHIMI I BUXHETIT DHE FINANCAVE | Planifikimi jo adekuat i buxhetit vjetor komunal | Të sigurohet pjesëmarrja e të gjitha palëve relevante gjatë planifikimit të buxhetit. | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunale | TM1 TM2 dhe TM3 TM4 2025 | Për të garantuar planifikim gjithëpërfshirës të buxhetit, u synua përfshirja e të gjitha palëve relevante nën udhëheqjen e Kryetarit të Komunës dhe drejtorive komunale. Edhe pse buxheti për vitin 2025 u hartua në përputhje me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve dhe prioritetet komunale, miratimi i tij u vonua për shkak të mungesës së konsensusit politik në Kuvendin Komunal.<br><br>Situata u tejkalua përmes seancave urgjente dhe konferencave të jashtëzakonshme, dhe pas shtatë muajsh bllokadë, buxheti u miratua në fund të shkurtit, duke mundësuar funksionimin normal të komunës. | E realizuar, me vonesë. | Mungesë bashkëpunimi pozitë–opozitë.<br><br>Me shpresë që pas zgjedhjeve lokale, viti 2026 të sjellë një qeverisje funksionale dhe më të përkushtuar ndaj prioritetit kryesor të komunës: menaxhimit serioz dhe efikas të buxhetit. | Dëgjimev buxhetore 20<br><br>Raporti performancës | |
| 3.1 | | Shpenzimi i buxhetit jo në mënyrë adekuate | Raportim i rregullt për shpenzimet buxhetore. | Kryetari i Komunës, | TM1 TM2 dhe TM3 | Për të parandaluar shpenzimin jo të duhur të buxhetit dhe për të rritur transparencën, Kryetari i Komunës dhe drejtoritë komunale kanë siguruar raportim të rregullt dhe të detajuar për | E realizuar! | Raportet mujore në faqen zyrtare të Komunës së Gjilanit https://gjilan.rks- | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | dhe jo mjaftueshëm transparent | | Drejtorit Komunale | TM4 2025 | shpenzimet buxhetore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.<br>Gjatë vitit 2025 janë publikuar raporte financiare mujore, tremujore dhe vjetore, duke garantuar qasje publike dhe kontroll mbi përdorimin e fondeve publike | | gov.net/raportet-mujore | | |
| 3.2 | | Të sigurohet mbikëqyrja e jashtme mbi zbatimin e buxhetit duke krijuar një komision të përbërë nga përfaqësuesit e komunës dhe nga vëzhgues të OJQ-ve për të monitoruar zbatimin e buxhetit. | Kryetari i komunës dhe Drejtoria për buxhet dhe financa | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunale | TM1 TM2 dhe TM3 TM4 2025 | Në vitin 2025, Komuna e Gjilanit ka vazhduar bashkëpunimin aktiv me OJQ-të lokale, përmes thirrjeve publike, takimeve konsultative dhe mbështetjes së projekteve në fushat e rinisë, kulturës, sportit dhe shërbimeve sociale.<br><br>Ky bashkëpunim ka synuar rritjen e pjesëmarrjes qytetare, transparencës dhe përfshirjes së shoqërisë civile në proceset vendimmarrëse dhe zhvillimore të komunës, siç dëshmohet nga aktivitetet dhe njoftimet e publikuara gjatë vitit 2025 në faqen zyrtare të Komunës së Gjilanit. | **E realizuar!** | Lista-paraprake-e-OJQ-ve-perfituese-sip<br><br>Lista-perfundimtare-e-projekt-propozim<br><br>Certificate Eronita_Mehmeti.pd | Akterët institucionalë dhe OJQ-të nuk e kanë të kufizuar efektivitetin e monitorimit të zbatimit të buxhetit. | |
| 3.3 | | Inventarizimi dhe regjistrimi joefikas i aseteve komunale | Të përditësohet regjistri i brendshëm i aseteve të komunës | Kryetari i Komunes Drejtorit Komunale | TM1 TM2 dhe TM3 TM4 2025 | Me qëllim të rritjes së saktësisë dhe transparencës në menaxhimin e aseteve komunale, gjatë vitit 2025 është përditësuar rregullisht regjistri i brendshëm i aseteve.<br><br>Procesi është mbështetur nga raportet e komisioneve të inventarizimit dhe vlerësimit (SIMFK), si dhe nga formimi i komisioneve komunale dhe atyre nëpër drejtori për ri-verifikimin e aseteve.<br><br>Pas përfundimit të inventarizimit të pasurisë jo kapitale, Kryetari i Komunës ka autorizuar, përmes Vendimit Nr. 02/742, datë 04.06.2025, një zyrtare për përditësimin e të dhënave në sistemin elektronik **e-Pasuria**, proces i cili është në zbatim të rregullt. | E realizuar! | Vendimet e Kryetarit dhe sistemi e-Pasuria https://gjilan.rks-gov.net/vendimet-e-kryetarit/ | Nuk ka! | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4. | RUAJTJA DHE SIGURIA E TË DHËNAVE DHE DOKUMENTACIONIT | Siguria e pamjaftueshme e të dhënave në sistemet e teknologjisë informative si dhe përdorimi i tyre për qëllime jo-zyrtare | | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunale<br><br>Zyra e IT | TM1 TM2 dhe TM3 TM4 2025 | Sistemet IT monitorohen dhe mirëmbahen në përputhje me udhëzimet e ASHI-së (Agjencia e Shoqërisë së Informacionit) dhe Ministrisë së Linjës.<br><br>Lansimi i faqes së re të komunës për akses të sigurt të të dhënave : **https://gjilan.rks-gov.net/** | **E realizuar!**<br><br>https://ekosova.rks-gov.net/PrivacyPolicy/ | Nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit kemi shume e-mail paralajmërues | Kapacitet i kufizuar lokal për zbatim të plotë të udhëzimeve qendrore | |
| 4.1 | | Zhvillimi dhe miratimi i procedurës së punës për proceset që realizohen përmes sistemeve të teknologjisë informative | | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunale<br><br>Zyra e IT | TM1 TM2 dhe TM3 TM4 2025 | Nuk ka pasur ndryshime të veçanta gjatë periudhës janar– dhjetor 2025 te gjitha procedurat ekzistuese janë zbatuar.<br><br>Përditësimi dhe rishikimi i procedurave për t'u përshtatur me ndryshimet e shpejta teknologjike | **E realizuar!**<br><br>mbetet konstant, | https://ekosova.rks-gov.net/PrivacyPolicy/ | Sfidat e sigurisë në një mjedis teknologjik me ndryshime të shpejta | |
| **Të dhënat e Planit të Integritetit** | | | | | | **Raportimi i zbatimit** | | | | |
| 1. | AUDITIMI I BRENDSHËM | Mungesa e planifikimit të auditimit të bazuar në rrezik dhe auditimeve rast pas rasti | Hartimi i planit të auditimit të brendshëm bazuar në rezultatin e vlerësimit të rrezikut | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunale | TM1 TM2 dhe TM3 TM4 2025 | Hartimi i Planit Strategjik dhe Planit Vjetor të Auditimit; përdorimi i formularëve standard (1017, 3002) dhe përgatitja e raporteve finale.<br><br>Përmirësimi i bashkëpunimit institucional dhe përdorimi më efektiv i burimeve për zbatimin e planit | E realizuar | https://gjilan.rks-gov.net/plani-i-veprimit | Burime të kufizuara për auditime dhe koordinim i nevojshëm më i mirë midis strukturave përgjegjëse | |
| 1.1 | | Auditimet rast pas rasti | Mosverifikimi i plotë i të gjeturave | Kryetari i Komunës | TM1 TM2 dhe | Zyra Komunale e Auditimit ka realizuar auditime të brendshme gjatë gjithë vitit2025. | **E realizuar!**<br><br>. | https://zka-rks.org/ ;<br>https://gjilan.rks- | Forcimi i kapaciteteve dhe | . |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | nga inspektimet | Drejtorit Komunale | TM3 TM4 2025 | Komisioni Komunal i Auditimit ka mbikëqyrur procesin dhe monitoruar shpenzimet publike | | gov.net/njesia-e-auditimit-te-brendshem/ | trajnime shtesë për auditim | |
| 1.2 | | Mbikëqyrja e zbatimit të rekomandimeve të auditimit | Mungesë e mbikëqyrjes profesionale mbi zbatimin e rekomandimeve të auditorit | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunale | TM1 TM2 dhe TM3 TM4 2025 | Njësia e Auditimit të Brendshëm ka përgatitur raportin vjetor të auditimit për periudhën 01.01.2024–31.12.2024 dhe e ka dorëzuar me kohë. | **E realizuar!** | https://zka-rks.org/ ; https://gjilan.rks-gov.net/njesia-e-auditimit-te-brendshem/ | Vështirësi në grumbullimin e të dhënave. | Përmirësimi i koordinimit dhe përgatitja cilësore e raporteve brenda afateve |
| 1.4 | Koordinimi ndërinstitucional në auditim | Mungesë koordinimi ndërmjet Njësisë së Auditimit të Brendshëm dhe Komisionit të Auditimit, | Përmirësimi i komunikimit dhe koordinimit ndërinstitucional | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunale | TM1 TM2 dhe TM3 TM4 2025 | Pas rekomandimeve të auditimit, drejtoritë kanë përgatitur Plane Veprimi (formulari 3003) në koordinim me Njësinë e Auditimit përmes komunikimit formal dhe takimeve. | **Në proces!**<br><br>https://zka-rks.org/ ; https://gjilan.rks-gov.net/njesia-e-auditimit-te-brendshem | https://zka-rks.org/ ; https://gjilan.rks-gov.net/njesia-e-auditimit-te-brendshem | Mosrespektimi i afateve për dorëzimin e Planeve të Veprimit dhe forcimi i koordinimit ndërmjet njësiv | . |
| 2. | PROKURIMI PUBLIK | Kapacitete të pamjaftueshme në përgatitjen e specifikimeve të tenderit dhe rrezik i diskriminimit | Rritja e kapaciteteve dhe hartimi i specifikimeve neutrale | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunale | TM1 TM2 dhe TM3 TM4 2025 | Zyra e Prokurimit ka zbatuar Ligjin për Prokurimin Publik, duke hartuar specifikime teknike në përputhje me nenet 7, 68 dhe 69 të LPP-së. | **E realizuar!** | https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx<br><br>https://gjilan.rks-gov.net/njoftim-per-kontrate | Vështirësi në interpretimin e kërkesave teknike nga njësitë kërkuese | . |
| 2.1 | Përgatitja e specifikimeve të tenderit | Përgatitje joefikase e specifikimeve të tenderit | Rritja e transparencës dhe mbikëqyrjes në procesin e prokurimit | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunale | TM1 TM2 dhe TM3 TM4 2025 | Publikimi i plotë i dokumentacionit të tenderëve dhe komunikimi ekskluziv përmes platformës e-prokurimi, sipas standardeve të KRPP-së. | **E realizuar!** | https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx/<br><br>https://gjilan.rks-gov.net/njoftim-per-kontrate/ | Mungesë njohurish të operatorëve ekonomikë për përdorimin | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | e platformës | |
| 2.2 | Kapacitetet në prokurimin publik | Mungesë e njohurive dhe aftësive profesional e në prokurim publik | Organizimi i trajnimeve dhe punëtorive për personelin e prokurimit dhe njësitë kërkuese | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunale | TM1 TM2 dhe TM3 TM4 2025 | Stafi i Zyrës së Prokurimit dhe njësive kërkuese ka marrë pjesë në trajnime të KRPP-së dhe punëtori profesionale; pjesë e stafit është certifikuar | **E realizuar!** | https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=277 | Ngarkesë e lartë e punës ka kufizuar pjesëmarrjen e plotë | Planifikim më i mirë i kohës dhe vazhdim i trajnimeve periodike |
| 2.3 | Transparenca në prokurimin publik | Mos-transparencë dhe mbikëqyrje e pamjaftueshme e prokurimit publik | Publikimi i Planit të Prokurimit dhe informacioneve relevante | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunale | TM1 TM2 dhe TM3 TM4 2025 | Të dhënat e prokurimit dhe Plani i Prokurimit janë publikuar në platformën e-Prokurimit; ankesat trajtohen përmes OSHP-së | **E realizuar!** | https://oshp.rks-gov.net/<br><br>https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=205/ | Njohuri të kufizuara të qytetarëve për përdorimin e platformave | Informim dhe udhëzime publike për rritjen e qasjes dhe monitorimit qytetar |
| 2.4 | Komunikimi me ofertuesit në prokurim | Mundësi për komunikim joformal dhe jo të kontrolluar me ofertuesit | Krijimi i protokollit të qartë dhe pikave zyrtare të kontaktit | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunale | TM1 TM2 dhe TM3 TM4 2025 | Kuvendi i Komunës ka miratuar Rregulloren (KGJ) Nr. 1/2025 për Transparencë, e cila përcakton rregulla të qarta për komunikim dhe transparencë institucionale | E realizuar! | https://gjilan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/05/Rregullorja-per-transparence-komunale-2025.pdf/ | Nuk ka! | |
| 3. | MENAXHIMI I KONTRATAVE PUBLIKE | Mungesë e stafit profesional për menaxhimin e kontratave | Menaxhimi i kontratave nga zyrtarë me kompetencë profesionale. | Njësia e Prokurimit Publik | TM1 TM2 dhe TM3 TM4 2025 | Njësia e Prokurimit Publik ka funksionuar me staf të trajnuar dhe kompetent; kontratat janë mbikëqyrur dhe zbatuar rregullisht | **E realizuar!** | https://gjilan.rks-gov.net/raportet-12/ | Nevojë për ekspertizë shtesë në kontrata komplekse | |
| 3.1 | Kapacitetet për menaxhimin e kontratave | Mungesë e aftësive profesional e për menaxhimin e kontratave | Trajnimi i zyrtarëve për menaxhimin e kontratave | Njësia e Prokurimit Publik | TM1 TM2 dhe TM3 TM4 2025 | Zyrtarët komunalë kanë marrë pjesë në trajnime të KRPP-së dhe IKAP-it për menaxhimin e kontratave | **E realizuar!** | https://krpp.rks-gov.net/<br><br>https://ikap.rks-gov.net/m | Sigurimi i pjesëmarrjes së rregullt në trajnime | Planifikim më i mirë i pjesëmarrjes dhe vazhdim i trajnimeve periodike |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3.2 | Kompensimi për menaxhimin e kontratave | Mos-kompensimi i zyrtarëve të përfshirë në menaxhimin e kontratave dhe trajnime | Hartimi dhe zbatimi i një mekanizmi kompensimi për personelin | Njësia e Prokurimit Publik | TM1 TM2 dhe TM3 TM4 2025 | Deri më tani nuk është aplikuar asnjë formë kompensimi për stafin e përfshirë në trajnimet dhe menaxhimin e kontratave | **Në proces!** | https://gjilan.rks-gov.net/raportet-13/ | Mungesa e rregullorev e dhe mjeteve buxhetore | |
| 4. | ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL DHE BUJQËSIA | Mos-rishikimi dhe miratimi i dokumenteve strategjike dhe masave për zhvillim ekonomik dhe mbështetje të bizneseve | Hartimi, rishikimi dhe miratimi i dokumenteve strategjike për zhvillim ekonomik të komunës | Kryetari i komunës<br><br>Drejtoria për Zhvillim Ekonomik | TM1 TM2 dhe TM3 TM4 2025 | Iniciativat për Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik 2024–2031, faljen e borxheve të bizneseve dhe lirimin nga taksa komunale për vitin 2025 janë propozuar dhe dërguar për miratim. | **Në proces!** | DRAFT - Strategjia per Zhvillim Ekonom | Bllokada politike nga opozita ka penguar miratimin e vendimeve kyçe | |
| 4.1 | | Mos-rishikimi dhe mos-funksionimi i mekanizmave për vendimmarrje në zhvillim ekonomik | Rishikimi i prioriteteve të zhvillimit ekonomik dhe funksionalizimi i plotë i Kuvendit Komunal | Kryetari i komunës<br><br>Drejtoria për Zhvillim Ekonomik | TM1 TM2 dhe TM3 TM4 2025 | Hartimi i prioriteteve për 2025, duke përfshirë: bashkëpunim ndërpartiak, mbështetje për bizneset lokale, miratimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik 2024–2031, nxitjen e investimeve, zhvillimin e projekteve me perspektivë ekonomike | **Në proces!** | https://gjilan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/06/Komuna-e-Gjilanit-Profili-Ekonomik-2024-1.pdf/ | Bllokadat politike pengojnë miratimin dhe zbatimin e iniciativave strategjike | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4.2 | | Qëllimet dhe prioritetet e zhvillimit ekonomik të komunës të paqarta dhe jo-transparente | Sigurimi i pjesëmarrjes së të gjitha palëve relevante gjatë hartimit dhe caktimit të prioriteteve të zhvillimit komunal | Kryetari i komunës<br><br>Drejtoria për Zhvillim Ekonomik | TM1 TM2 dhe TM3 TM4 2025 | Hartimi i dokumenteve strategjike me përfshirjen aktive të të gjitha palëve, përkthim në gjuhën serbe dhe përfshirja e Zyrës për Kthim dhe Komunitete për garantimin e përfaqësimit të komuniteteve jo-shumicë | **E realizuar!** | Fondi për subvencionimin e bi<br><br>VODIČ ZA PRIMENU I.pdf | Nuk ka vështirësi të mëdha; procesi ka pasur menaxhim të mirë | |
| 4.3 | | Kritere jo të qarta dhe transparencë të pa mjaftueshme në ndarjen e subvencioneve | Zhvillimi i rregullativës dhe procedurave të qarta për ndarjen e subvencioneve, me përfshirjen e shoqërisë civile | Kryetari i komunës<br><br>Drejtoria për Zhvillim Ekonomik | TM1 TM2 dhe TM3 TM4 2025 | Përfundimi i programit për vitin 2025 dhe organizimi i dëgjimeve publike<br><br>[https://gjilan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/06/Lista-e-aplikacioneve-perfituese-per-Subvencionet-Bizneset-START-UP-dhe-Bizneset-Ekzistuese-te-Grave-2025-1.pdf](https://gjilan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/06/Lista-e-aplikacioneve-perfituese-per-Subvencionet-Bizneset-START-UP-dhe-Bizneset-Ekzistuese-te-Grave-2025-1.pdf) | **E realizuar!** | Publikimet e dokumenteve zyrtare dhe raportet periodike të Drejtorisë | Kapacitetet buxhetore dhe pritshmëritë e larta nga qytetarët mund të ndikojnë në implementim | |
| 5. | PLANIFIKIMI URBAN DHE RURAL | Mangësi në rregullat e brendshme që lidhen me fushën e planifikimit urban dhe rural | Të zhvillohet rregullativa e brendshme duke përcaktuar kritere të qarta të duhura që adresojnë rreziqet kryesore në procesin e planifikimit urban dhe rural dhe parandalojnë vendimet subjektive | Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit<br><br>Njësia Planifkimit | TM1 TM2 dhe TM3 TM4 2025 | Komuna e Gjilanit ka miratuar procedura të brendshme që përcaktojnë kritere të qarta për planifikimin urban dhe rural, duke reduktuar subjektivitetin dhe vendimet të bazuara në kontakte personale; vendimet marrin vetëm zyrtarë profesionalë.<br><br>Procedurat janë hartuar dhe miratuar, dhe janë duke aplikuar në praktikë, duke garantuar përmbushjen e objektivave.<br><br>Zbatimi i kërkesave të reja kërkon trajnim të mëtejshëm të stafit. | **E realizuar!** | 0002. Vendimi per PZHK - Komuna e Gji<br><br>0001. Vendimi per PZHK - Komuna e Gji<br><br>0003. Vendimi per Trajtimin Ndërtimeve | Mund të hasen sfida në interpretimin uniform të rregullave nga stafi i ndryshëm dhe gabime formale gjatë zbatimit | |
